



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 52

2001

Nëntor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.605, datë 13.10.2001	Për kurset e formimit profesional, të kualifikimit e specializimit në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari”	1673
Vendim i KM nr. 606, datë 9.11.2001	Për miratimin në parim të protokollit të dyt shtesë të Konventës së Këshillit të Europës për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale.....	1675
Vendim i KM nr. 607, datë 12.11.2001	Për shpërndarjen e parakohshme të Këshillit të Komunës Kolsh të Qarkut të Lezhës.....	1675
Vendim i KM nr. 623, datë 12.11.2001	Për financimin e zgjedhjeve të pjesshme për deputet, në zonën zgjedhore nr.98.....	
Vendim i GJK nr. 178, datë 8.11.2001	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr.8377, datë 22.7.1998 “Për shpalljen e moratoriumit për detyrimet e pashlyera të ish-ndërmarrjeve të Tregtisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë kundrejt kreditorëve të huaj.....	
Vendim i GJK nr. 179, datë 12.11.2001	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.37, datë 25.5.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.626, datë 26.4.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....	

V E N D I M
Nr. 605, datë 13.10.2001

**PËR KURSET E FORMIMIT PROFESIONAL, TË KUALIFIKIMIT E SPECIALIZIMIT NË
AKADEMINË E POLICISË “ARBEN ZYLYFTARI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 18 dhe të pikës 5, të nenit 63, të ligjit 8553, dastë 25.11.1999, “Për Policinë e shtetit”, të pikës 1, të nenit 10, të pikës 1, të nenit 12, të pikës 2, të nenit 13, të pikës 3, të nenit 16, të ligjit 8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit”, dhe të nenit 7, të ligjit 8718, datë 19.12.2000, “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2001”, me propozimin e Minsitrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. në Akademi të Policisë “Arben zylyftari” të hapen kurse formimi profesional, kurse kualifikimi dhe kurse specializimi për nevoja aftësimi dhe kualifikimi të personelit, për mbrojtjen e rendit e të sigurisë publike, të luftës për parandallimin dhe zbulimin e krimeve, si dhe për përshtatjen e nivelit profesional me kërkesat e roleve, të geradave dhe të funksioneve organike.

Në raste të veçanta e për profile të ngushta, kurset e kualifikimit e të specializimit, kur nuk ekzistojnë mundësitë, kryhen edhe pranë institucioneve të tjera, arsimore apo kërkimore e shkencore, ushtarake ose civile, etj, brenda dhe jashtë vendit, në bazë të marrëveshjeve paraprake.

2. Akademia e Policisë “Arben Zylyftari” hap kurse kualifikimi edhe për punonjësit e policive të tjera, sipas kritereve të përcaktuara në paragrafin e katërt, të pikës 5, të vendit nr.281, datë 2.6.2000, të Këshillit të Ministrave.

SHKALLËZIMI I KURSEVE DHE KOHËZGJATJE E TYRE

3. Kurset e formimit profesionale, të kualifikimit e të specializimit, organizohen sipas këtij shkallëzimi e kohëzgjatjeje:

3.1. Kurset e formimit profesional:

a. Për rolin bazë: - Kurs 1-vjeçar (akademik), në Institutin e Policisë për personat e pranuar rishtaz dhe 3-mujorë për punonjësit e policisë efektive, që nuk kanë kryer kurs të tillë.

b. Për rolin e mesëm: - Kurs i plotë i studimeve të larta 3-vjeçare në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari”.

c. Kurs nga 4 muaj deri në 1 vit (akademik), në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari”, për ata që janë pranuar apo pranohen pas përfundimit të një shkolle tjetër të lartë.

3.2. Kurset e kualifikimit (karrierë):

a. Për rolin bazë: - Nga agjent i parë në asistent dhe nga asistent i parë në kryeasistent nga 3 deri në javë.

b. Për rolin e mesëm: - Nga inspektor në kryeinspektor 4 javë dhe nga kryeinspektor në nënkomisar, 12 javë.

c. Për rolin e lartë: - Nga komisar në kryekomisar 4 javë dhe nga kryekomisar në drejtues, 12 javë.

d. Për rolin madhor: - Kurse afatshkurtë për drejtimin strategjik, bashkërendimin dhe kontrollin gjatë ushtrimit të detyrës.

3.3. Kurse e specializimit, sipas shpëblimeve policore vepruese e mbështetëse (brenda roleve).

a. Për rolin bazë, nga 2 deri në 12 javë.

b. Për rolin e mesëm, nga 2 deri në 8 javë.

c. Për rolin e lartëm nga 2 deri në 4 javë.

ORGANIZIMI I KURSEVE

4. Hapja e kurseve të formimit, kualifikimit e specializimit të rolit bazë, bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të policisë dhe për rolin e mesëm, të lartë dhe madhor me urdhër të Ministrisë të Rendit Publik, në bazë të propozimit të drejtorit të përgjithshëm të Policisë.

5. Programet për çdo kurs formimi, kualifikimi e specializimi, për të gjitha rolet, hartohen e miratohen nga Akademia e Policisë. Për zbatimin e tyre, përveç trupës pedagogjike, efektive, aktivizohen dhe specialistë brenda e jashtë sistemit të Ministrisë së Rendit Publik apo të misioneve dhe organizmave të huaja policore.

6. Kurset e formimit për rolin bazë të mesëm, kurset e kualifikimit dhe të specializimit brenda roleve dhe ato për kalimin nga njëri rol në tjetrin, bëhen me shkëputje nga puna e sipas afateve të përcaktuara në këtë vendim.

Në përfundim të çdo kursi jepet dëshmi nga derjtori i Akademisë së Policisë.

TRAJTIMI EKONOMIK E FINANCIAR

7. Punonjësit e policisë, që dërgohen në kurset e formimit profesional, të kualifikimit e të specializimit kur janë në marrëdhënie pune përfitojnë pagën mujore të funksionit organik që kanë patur para fillimit të kursit.

8. Studentëve dhe kursantëve, që pranohen në Akademinë e Policisë dhe në Institutin e Policisë nga jeta civile, u jepet, 30 për qind e pagesës mujore të gradës më të ulët ipas rolit, në gjysmën e parë të periudhës së kursit dhe 50 për qind, e po kësaj pagese, në gjysmën e dytë të kësaj periudhe.

Personat që vijnë pas përfundimit të një shkolle tjetër të lartë përfitojnë pagën mujore të gradës më të ulët të rolit të mesëm (nënispektor).

9. Të drejtat ekonomike, sipas pikave 7 dhe 8, i gëzojnë personat edhe kur dërgohen në kurse formimi, kualifikimi e specializimi jashtë shtetit.

10. Pagesa e kursantëve, për kohën e qëndrimit në kurs deri në 4 muaj, bëhet në qendrën e punës, ku ata janë efektivë, ndërsa ata që vazhdojnë kurse mbi këtë afat, paguhen në qendrën e formimit, kualifikimit e specializimit.

11. Studentëve të akademisë, kursantëve të institutit dhe punonjësit të tjerë që vijnë për t'u kualifikuar e specializuar, për afatin kohor të zhvillimit të kursit, u garantohet fjetja dhe ushqimi pa pagesë.

Trajtimi me ushqim të bëhet sipas normës nr.4 “të studentëve”, të vendimit nr.160, datë 9.7.1975, të Këshillit të Ministrave, “Mbi normat e ushqimit të efektivit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme”, ndërsa trajtimi ushqimor i kursantëve për Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë dhe Forcat Speciale të bëhet sipas normës përkatëse.

Rastet e përdorimit të ormës, konkrete, ushqimore përcaktohen në urdhrin e çdo kursi.

12. Në rastet kur për kurse deri në 1 muaj, nuk ka mundësi për të siguruar fjetjen dhe ushqimin në akademi, institut apo në ndonjë vend tjetër, kursantëve u paguhen shpenzimet me dieta.

13. Efektet financiare përballohen nga Buxheti i Shtetit, miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.

14. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, që në zbatim të këtij vendimi të nxjerrin aktet nënligjore për formimin, kualifikimin e specializimin e punonjësit të Policisë së Shtetit.

15. Vendimi nr.295, datë 18.7.1964, i Këshillit të Ministrave ndryshuar me vendimin nr.55, datë 8.4.1970, si dhe aktet e tjera nënligjore që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 606, datë 9.11.2001

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROTOKOLLIT TË DYTË SHITESË TË KONVENTËS
SË KËSHILLIT TË EUROPËS, PËR NDIHMËN E NDËRSJELLË JURIDIKE NË FUSHËN
PENALE**

Në mbështetje të neneve 100, 117, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të protokollit të dytë shtesë të Konventës së Këshillit të Europës, për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.607, datë 2.11.2001

**PËR SHPËRNDARJEN E PARAKOHSHME TËËSHILLIT TËUNËS, KOLSH, TË QARKUT
TË LEZHËS**

Në mbështetje të neneve 100, 115, pika 1, të Kushtetutës, të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 38, të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shpërndarjen e parakohshme të këshillit të komunës, Kolsh, të qarkut të Lezhës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.623, datë 12.11.2001

**PËR FINANCIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR DEPUTET,
NË ZONËN ZGJEDHORE NR.98**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 7, të ligjit nr.8718, datë 19.12.2000, "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2001", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të përdorë fondin prej 3 200 000 (tre milionë e dyqind

mijë) lekësh, për financimin e zgjedhjeve të pjesshme për deputet, në zonën zgjedhore nr.98, që zhvillohen më datë 18 nëntor 2001.

2. Ky fond të përballohet nga zëri “fondi rezervë“ i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i miratuar për financimin e fushatës zgjedhore, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr.301, datë 12.5.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2001, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e fushatës zgjedhore për në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar me vendimet nr.352, datë 23.5.2001, dhe nr. 405, datë 11.6.2001, të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

VENDIM
Nr.178, datë 8.11.2001

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli,	Anëtar i““
Alfred Karamuço,	Anëtar i““
Kujtim Puto,	Anëtar i““
Kristofor Peçi,	Anëtar i““
Petrit Pllloçi,	Anëtar i““
Tefta Zaka	Anëtar i““
Sokol Sadushi	Anëtar i““
Zija Vuci,	Anëtar i““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 26.6.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.60 Akti që i përket:

KËRKUES: AVOKATI I POPULLIT, zoti Ermir Dobjani.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

- 1.KUVENDI I SHQIPËRISË, në mungesë
- 2.KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë
- 3.MINISTRIA E FINANCAVE, në mungesë

OBJEKTI:

Shfuqizimi si antikushtetues i ligjit nr.8377, datë 22.7.1998 “Për shpalljen e moratoriumit për detyrimet e pashlyera të ish-Ndërmarrjeve të Tregtisë së jashtme të Republikës së Shqipërisë kundrejt kreditorëve të huaj”.

BAZA LIGJORE: Nenet 7, 42/1 e 134/dh të Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane “Për ruajtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”; neni 24 ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Shfuqizimin e këtij Avokati i Popullit e ka kërkuar për këto shkaqe:

Përmbajtja e nenit vjen në kundërshtim me nenin 7 yë Kushtetutës, ku sanksionohet ndarja dhe ballancimi i tre pushteteve pasi lejon ndërhyrjen direkte të një pushteti tjetër në kompetencat që i garanton Kushtetuta pushtetit gjyqësor. Pezullimi i gjykimeve dhe i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore janë prerogativa të natyrshme të këtij të fundit, pasi në këtë rrugë ka ecur edhe praktika e Gjykatës Kushtetuese në zgjidhjen që ajo i ka dhënë këtij problemi me vendimin e sj nr.9, datë 31.7.1995.

Gjatë gjykimit ai e ka zgjeruar objektin e kësaj kërkesë dhe ka kërkuar shfuqizimin e krejt ligjit, duke parashtruar edhe shkaqe të tjera në mbështetje të kësaj teze.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Zija Vuci, kërkuesin i cili kërkoi të shfuqizohet i gjithë ligji “Për shpalljen e moratoriumit” si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.2320, datë 21.5.1997 e ka detyruar Ndërmarrjen Shtetërore Alkop Tiranë t’i paguaj firmës tregtare turke “Adria Ulusbararasi” 515694 dollarë USD dhe 483534 marka gjermane për llogari të një borxhi që rrjedh nga marrëdhëniet kontraktore midis kësaj të fundit dhe ish-ndërmarrjeve të Tregtisë së jashtme të shtetit Shqiptar.

Mbi ankimin e anës së paditur Alkopit Tiranë, çështja i ka kaluar për shqyrtim Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila me vendim nr.2504, datë 31.10.1997 ka vendosur pushimin e gjykimit.

Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs Shaban Yildyrum, president i firmës turke. Kolegji civil i Gjykatës së kasacionit me vendimin nr.975, datë 16.6.1998 ka vendosur prishjen e vendimit të sipërm të Gjykatës së Apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po në këtë gjykatë por me tjetër trup gjykues. Nga ana e kësaj gjykate çështja është vënë në lëvizje dhe më datë 7.10.1998. Ajo duke zbatuar paragrafin e tretë të nenit 1 të ligjit nr.8377, datë 22.7.1998 “Për shpalljen e moratoriumit për detyrimet e pashlyera të ish-ndërmarrjeve të Tregtisë së jashtme të Republikës së Shqipërisë kundrejt kreditorëve të huaj”, ka vendosur pezullimin e shqyrtimit të çështjes pasi kjo dispozitë urdhëron pezullimin e të gjitha çështjeve civile që janë në shqyrtim në çdo hallkë gjyqësore si edhe të vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Gjykata e Apelit Tiranë e ka vënë përsëri në lëvizje këtë çështje dhe me vendimin nr.370, datë 13.4.2000 në bazë të nenit 468 të Kodit të procedurës Civile, pa prnainë e palëve ka vendosur, prishjen e vendimit nr.2320, datë 21.5.1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

Në këto rrethana firma tregtare turke “Adria Ulusbararasi” nëpërmjet titullarit të saj i është drejtuar për zgjidhjen e këtij problemi Avokatit të Popullit, i cili ka bërë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të ligjit të sipërpërmendur.

Gjykata Kushtetuese pa i hyrë çështjes në themel arriti në konkluzion se kjo kërkesë e Avokatit të Popullit duhet të rrëzohet.

Një zgjidhje e tillë gjen mbështetje në nenin 134 pika 2 të Kushtetutës. Në vështrim të kësaj dispozite Avokati i Popullit nuk legjitimohet të verë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Çështja që ai ka ngritur dhe që ka për objekt shfuqizimin si antikushtetues të këtij akti normativ të organit ligjvënës njk lidhet me interesat e tij. Asnjë normë e këtij ligji nuk del të ketë prekur strukturën organizative të institucionit që ai drejton, të ketë cënuar sadopak statusin e tij si person ose të punonjësve të tjerë të këtij institucioni, apo ta ketë penguar atë në ushtrimin e kompetencave që kanë lidhje me funksionin e tij, rrethana këto që përmenden në mënyrë indikative edhe në vendimin interpretues nr.49, datë 31.7.2000 të Gjykatës Kushtetuese. Pra, pa qenë të pranishme këto rrethana Avokati i Popullit nuk mund t’i drejtohet gjykatës Kushtetuese dhe ta investojë atë në shqyrtimin e çështjes.

E njëjhtë është poezia e tij edhe përsa i përket çështjeve që i takojnë juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Në këto gjykime Avokati i Popullit kur nuk ka vetë interes nuk mund të ndërhyjë me cilësinë e palës ose të reagojë kundër vendimeve të këtyre organeve, duke i kërkuar Gjykatës

Kushtetuese që t'i deklarojë ato antikushtetuese.

Në këto raste është vetë individi ai që ka të drejtë të vërë në lëvizje këto gjykata, madje edhe Gjykatën Kushtetuese, kur gjatë gjykimit të zakonshëm nuk janë respektuar kërkesat për një proces të rregullt ligjor.

Veç kësaj, në çdo fazë dhe shkallë të këtij gjykimi si individi ashtu edhe gjykaa kryesisht, kanë të drejtë të vënë në dyshim kushtetutshmërinë e ligjit që do të zbatohet në çështjen konkrete dhe nëqoftëse gjykata çmon se ai vjen në kundërshtim me Kushtetutën, nuk e zbaton atë, por në bazë të nenit 145 të Kushtetutës pezullon gjykimin e çështjes dhe aktet ia dërgon gjykatës Kushtetuese që të shprehet kjo për kushtetutshmërinë e ligjit.

Pra, të drejtën për t'i kundërshtuar këto akte të pushtetit legjislativ dhe atij gjyqësor në Gjykatën Kushtetuese nuk e ka Avokati i Popullit. Në këto raste, Avokati i Popullit edhe në bazë të nenit 24 të ligjit të tij organik ka vetëm të drejtën e rekomandimit dhe jo të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

Kompetenca më të gjea ka Avokati i Popullit në sferën e veprimtarisë së administratës publike. Në bazë të nenit 60 të Kushtetutës funksionin e tij për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, ai mund ta ushtrojë pa kufizim. Kur këto vlera shkelen ose çënohen nga veprimet dhe mosverpimet e parregullta ose të paligjshme të organeve të administratës publike, qofshin ato edhe akte me karakter normativ, ai ka të drejtë t'i kundërvihet këtyre edhe duke ngritur kërkesa në Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin e akteve të tilla si antikushtetuese.

Në këtë rrugë ka ecur edhe praktika gjyqësore e kësaj Gjykata. Në një rast që i përket vendimit nr.26, dtë 24.4.2001, kjo e ka legjitimuar Avokatin e Popullit si subjekt aktiv në gjykim dhe ka pranuar kërkesën e tij për shfuqizimin si antikusthetues të pikës 1, shkronjës "c" të Vendimit nr.119, datë 18.3.2000 të Këshillit të Ministrave, pikërisht sepse ku akt ishte nxjerrë nga një porgan i administratës publike.

Ndryshe qëndron problemi që ngrihet në kërkesën objekt i këtij kontrolli kushtetues. Avokati i Popullit kërkon shfuqizimin e një ligji që dihet se nuk është akt i organeve të administratës publike. Prandaj, gjykata Kushtetuese duke iu referuar përmbajtjes së nenit 134, pika 2 dhe nenit 60 të Kushtetutës dhe duke i interpretuar këto dispozita të lidhura me njëra-tjetrën arrin në përfundimin se në kushtet kur objekt i kësaj kërkesë është shfuqizimi i një ligji për të cilin Avokati i Popullit nuk ka interes dhe jo shfuqizimi i një akti të organeve të administratës publike, atij i mungon legjitimimi sepse nuk ka cilësitë e subjekteve që kanë të drejta ta vënë atë në lëvizje.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 134 të Kushtetutës si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës për mungesë legjitimimi.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi fitën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 179, datë 12.11.2001

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Gjergj Sauli,	Anëtar i ““
Kujtim Puto,	Anëtar i ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““
Sokol Sadushi,	Anëtar i ““
Alfred Karamuço,	Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 15.10.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.136 Akti që i prket:

KËRKUES:AHMET METALIA, përfaqësuar nga Inspektori Hysni Beti e Adnor Shameti.
SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, përfaqësuar nga Inspektori Luan Dervishi.
2. PROKURORI I PËRGJITHSHËM, përfaqësuar nga prokurori Arqile Lole.

OBJEKTI:

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.37, datë 25.5.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.626, datë 26.4.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në kërkesë si shkaqe parashtrohen si vijon:

- Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe inspektorët kanë shkelur ligjin. Detyra e inspektorëve ishte të verifikonin shkeljen e të bënë akt-kontroll konkret. Në këtë mënyrë kërkuesit do t'i sigurohej e drejta e mbrojtjes;

- Në Kolegjet e Bashkuara në kundërshtim me nenin 85 paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës civile, në shqyrtimin e ankimit të kërkuesit nuk ka marrë pjesë prokurori edhe pse pjesëmarrja ka qenë e detyrueshme;

- Shkaku i vërtetë i mosparaqitjes në provimin e kualifikimit profesional ka qenë pamundësia fizike e kërkuesit, të cilën Gjykata e Lartë e ka provuar me raporte mjekësore.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, kërkuesin dhe përfaqësuesit e tij, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara si dhe analizoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr. 37, datë 25.5.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë zoti Ahmet Metalia është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Tiranë për shkak se nuk u paraqit pa arsye në provimin e kualifikimit profesional të organizuar në datat 8 e 15 maj 1999.

Gjykata Kushtetuese, në zbatim të nenit 131 shkronja “f” të Kushtetutës si për të gjithë individët ashtu edhe kërkuesit Ahmet Metalia e shikon lidhur ngushtësisht me sigurimin e një procesi të rregullt ligjor të zhvilluar në rrugën administrative apo në atë gjyqësore. Në këtë kuptim, pretendimin e kërkuesit lidhur me pamundësinë fizike për të marrë pjesë në provim, Gjykata e gjen jashtë kompetencave të veta e për pasojë nuk i hyn shqyrtimit e verifikimit përkatës.

Përsa i përket pretendimit tjetër të kërkuesit për mungesën e veprimeve paraprake nga

Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë që sipas kërkesit, kanë cënuar të drejtëne tij për mbrojtje në procesin administrativ, Gjykara Kushtetuese çmon se ai nuk qëndron.

Evidentimi i mungesës në provim si një veprim i disa gjyqtarëve i njohur botrisht nuk kishte nevojë për kontrolle nga ana e inspektorëve e për pasojë për mbajtje dokumentesh kontrolli. Për më tepër, mundësia që krijoi vetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë për t'u përgatitur e reflektuar disa ditë për shkeljen e vërtetuar, ishte garanci për të mis u cënuar e drejta e mbrojtjes e pretenduar nga kërkuesi.

Është e vërtetë, përse pretendon kërkuesi, si në shqyrtimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuar të Gjykatës së Lartë mungonte prokurori, pjesëmarrja e të cilit sipas nenit 85 të Kodit të Procedurës Civile, ka qenë e detyrueshme. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzion se mungesa e prokurorit nuk shkak për ta shpallur këtë proces të parregullt e për pasojë antikushtetues.

Në procesin gjyqësor administrativ, pjesëmarrja e prokurorit nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me ndonjë princip themelor mbi të cilin mbështetet procesi. Për praktikën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese pikërisht prekja e këtyre principeve i bën këto procese të parregullta e antikushtetuese. Për më tepër, me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, pozita e prokurorisë lidhet drejtpërdrejt me ushtrimin e ndjejes penale si dhe me përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit. Këto ndryshime me rëndësi parimore në pozitën e prokurorisë lidhet drejtpërdrejt me ushtrimin e ndjekjes penale si dhe me përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit. Këto ndryshime me rëndësi parimore në pozitën e prokurorisë kanë gjetur pasqyrim gradual edhe në legjislacion. Kështu, në ligjin nr.8577, datë 15.3.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë", nuk ka më dispozitë lidhur me pjesëmarrjen e prokurorit në gjykim. Po kështu, me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë", janë shfuqizuar në tërësi të gjitha dispozitat që rregullonin të drejtën e prokurorit për të ngritur padi si dhe të drejtat dhe detyrat për të marrë pjesë në gjykimin e çështjeve civile në të gjitha shkallët.

Nga sa u parashtrua më lart kërkesa duhet të rrëzohet sepse nuk qëndrojnë hkaqet që ngrihen tek ajo për proces të parregullt të zhvilluar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 e 134 të Kushtetutës si dhe nenti 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Rpublikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 26.12.2001
Doli nga shtypi më 26.12.2001

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2001